

IMPACT OF CORONAVIRUS PANDEMIC ON TEACHING CHARACTERISTICS

Teuta Iljazi

University of Tetovo, R.N.Macedonia, teuta.iljazi@unite.edu.mk

Abstract: The aim of this study is to determine the teachers opinions on online teaching. This research is a quantitative descriptive study using online survey methods. The sample collection method uses simple random sampling. The sample of this study is active teachers of Tetova University. This survey was completed and submitted by 39 teachers however the same was sent to a bigger number of teachers. The results of the data analysis obtained from the submitted responses can be concluded that the online teaching process carried out during the COVID-19 pandemic, which has been well managed, sufficient tools have been used to motivate students, although missuses of the circumstances have been present. This data also shows that the preferred teaching of teachers is the one with physical presence, where 61.5% of teachers share this opinion, while 35.9% of them prefer combined teaching.

Education and teaching

Keywords: education, online teaching, virtual classroom, teaching characteristics

IMPAKTI I PANDEMIS SË KORONAVIRUSIT TEK KARAKTERISTIKAT E MËSIMDHËNIES

Teuta Iljazi

Universiteti i Tetovës, R.M. Veriore, teuta.iljazi@unite.edu.mk

Abstrakti: Qëllimi i këtij studimi është të përcaktoj mendimet e mësimit në lidhje me mësimit online. Ky hulumtim është një studim kuantitativ përshkruar duke përdorur metodat e hulumtimit të kryer online. Metoda e mbledhjes së mostrës përdor mënyrën e rastësishme të përcaktimit. Mostra e këtij studimi janë mësimit aktiv të Universitetit të Tetovës. Grumbullimi primar i të dhënave në këtë studim u krye duke shpërndarë pyetësorin online mësimit të Universitetit të Tetovës. Pyetësorin e plotësuan 39 të anketuar, edhe pse i njëjti u dërgua një numri më të madhë të mësimit. Nga rezultatet e analizës së të dhënave të marra nga pyetësorët e plotësuar nga ana e mësimit mund të konkludohet që mësimit online e kryer gjatë pandemisë COVID-19, është menaxhuar mirë, janë përdorur mjete të mjaftueshme për të motivuar studentët, megjithëse kanë qenë të pranishme edhe keqpërdorime për shkak të rrethanave të krijuara. Këto të dhëna tregojnë gjithashtu se mësimit e preferuar e mësimit është ajo me prani fizike, ku 61.5% e mësimit ndajnë këtë mendim, ndërsa 35.9% e tyre preferojnë mësimit e kombinuar.

Arsim dhe mësimit

Fjalët kyçe: arsimimi, mësimit online, klasa virtuale, karakteristikat e mësimit

1. HYRJA

Arsimi në kuptimin e plotë të fjalës ka për qëllim zhvillimin e vlerave të një shoqërie. Sa më shumë të jetë i zhvilluar arsimi aq më tepër është e zhvilluar ndjenja e civilizuar për komb dhe shtet. Arsimi shpreh ndjenjën e planifikuar të zhvillimit të potencialit njerëzor, shpreh rrugën e zhvillimit të të menduarit për të vepruar drejt vlerave. Pa arsimin nuk do të ndodhte civilizimi njerëzor. Edukimi si proces pëson ndryshime me qëllim të plotësimit të nevojave të një shoqërie. Përhapja shumë e shpejtë e Coronavirusit në Planetin Tokë, ku si pasojë kishte edhe numër të madhë vdekjesh, ndikoi që edhe procesi i arsimit të zhvillohet më ndryshe. Ndryshimi ndodhi duke pasur parasysh kushtet sepse pandemia Covid-19 sipas UNESCO i detyroi 290 milion studentë ta ndërprejnë procesin mësimor (Purwanto et al. 2020). E njëjta gjë ndodhi edhe tek ne më 11.Mars 2020 u ndërpe procesi i mësimt, ditë e cila është e njohur edhe si ditë e Corona Pandemisë. Askush nuk mund të parashikonte një ndërprerje kohore kaqë të gjatë, e cila edhe sot pas një viti e gjysëm ende nuk jemi të sigurt nëse procesi i mësimt vitin e ardhshëm akademik nëse do të vazhdojë të funksionojë në mënyrë të rregullt.

Procesi arsimor kaloi nga një proces ku mësimit dhe studentët ishin prezent nëpër klasa, në një proces ku mësimit dhe studentët ndodheshin larg klasave, larg shkollave dhe universiteteve. Për një kohë relativisht të shkurtër sipas kushteve dhe njohurive me të cilat dispononin mësimit dhe studentët për mësimin online filloi procesi, ku nga largësia mësimit ndanin me studentët ligjeratat e tyre. Më vështirë ishte me shkollat fillore dhe të mesme, sepse Ministria e arsimit ishte e papregaditur për këtë lloj mësimit për shkak të mosinvestimit në kapitalin e tyre njerëzor- mësimit dhe mosndjekjes të risive në procesin mësimor. Mësimit e këtyre

shkollave duke ditur rëndësinë e shkollimit filluan komunikimin me nxënësit në mënyra të ndryshme, si rrjetet sociale, Viber ose WhatsApp duke i angazhuar nxënësit nga largësia në lidhje me materialin që duhej zhvilluar. Ky ka qenë një komunikim në kohë jo reale, jo i mjaftueshëm, i pakët dhe jo i organizuar mjaftueshëm.

Mësimdhënia online paraqet një dimension të ri në procesin arsimor. Njësoj si librat që e kanë ndëruar kuptimin për jetën dhe botën, ashtu edhe interneti i jep kuptim të ri procesit të edukimit. Mësimdhënia online si kuptim nuk është se nuk haset në procesin e edukimit në përgjithësi dhe në veçanti nëpër lëndë të ndryshme, por duhet të ceket se janë të pakta studimet në lidhje me praktikën e mësimdhënies online në periudhën para pandemisë Covid-19.

Në shumë vende mësimdhënia online ka përfshirje në edukimin e lartë. SHBA kanë qenë shtete të cilat kanë dhënë vend të rëndësishëm kompjuterit dhe internetit në procesin e edukimit në krahasim me Evropën. Sipas raportit të departamentit për edukim të SHBA mësimdhënia dhe të nxënësve online është popullarizuar, sepse e njëjta siguron qasje fleksibile ndaj përmbajtjeve dhe instruksioneve që janë të disponueshme për ata të cilët nuk janë në gjendje ta ndjekin mësimdhënien tradicionale. Gjithashtu, në këtë mënyrë bëhet shpërndarja më e efikase e përmbajtjeve mësimore, mundësohet rritja e komunikimit ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit, me çka rriten arritjet në të nxënës. Poashtu, sipas këtij raporti, disa ithtarë të teknologjisë mësimdhënien dhe të nxënësve online e shohin si potencial përtej rritjes së efikasitetit në dhënien e instruksioneve mësimore, si p.sh.: duke siguruar një komunitet nxënësish që me të kuptuarit e mbështesin kompleksitetin e njohurive (Riel and Polin, 2004; Schwen and Hara, 2004). Të tjerët argumentojnë se mësimdhënia dhe të nxënësve online siguron instruksione të individualizuara dhe të diferencuara (Archambault et al. 2010; Christensen and Horn 2008; Waldeck 2008; Watson and Gemin 2008), ku me anë të mekanizmave të ndryshme mund të merret feedback-u i menjëhershëm për performancën e nxënësit, (Dennen 2005; Rice et al. 2008). Vendet të cilat kanë aplikuar më parë mësimdhënien online kanë qenë në avatazh gjatë kohës së pandemisë, sepse ato kanë pasur të zhvilluar aplikacionet për mësimdhënien online, stafi mësimdhënës dhe studentët kanë qenë të pregaditur dhe kanë pasur përvojë me këtë lloj mësimdhënieje në krahasim me disa vende, shkolla, universitete të cilat u gjetën të papregaditura në këtë aspekt.

Pandemia Covid19 solli edhe risi në procesin e mësimdhënies, ku studentët filluan me të madhe të përdorin telefonat e tyre të mençur gjatë mësimdhënies, ku ky lloj i mësimdhënies dhe i të nxënësve njihet me emrin m-nxënie (m-learning). Kjo vegël (telefoni) është e përhapur tek të rritët sepse ofron mundësi që në çdo moment, në çdo vend me qasjen në internet të sigurojë komunikim, bashkëpunim, burime të ndryshme të dijes dhe aplikacione të ndryshme, të cilat mundësojnë të nxënësve të përgjithshëm. Aplikimi i telefonit mobil si vegël në procesin edukativ paraqet risi, sepse më herët nuk ka gjetur aspak zbatim ose shumë pak, por fatkeqësisht nuk është praktikuar aq sa duhet dhe nuk ka ndonjë metodologji të caktuar. Përvojat e pakta në mësimdhënien online sinkronike qoftë duke përdorur kompjuterët ose telefonat mobil në vendin tonë sjellin në mungesën e pasjes së veglave digjitale për mësimdhënie, e cila gjithë duhet avancuar për të arritur tek rezultatet e nevojshme të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Klasa ose mësojtorja është e përkufizuar si sistem komunikimi që i mundëson mësimdhënësit dhe nxënësit ta realizojnë në mënyrë sa më të efektshme procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve me ndihmën e mjeteve mësimore, me qëllim që të nxënësve të jetë permanent. Klasat tradicionale janë të krijuara në formën që të jenë të sigurta dhe të mbrojtura nga ambienti i jashtëm. Në dallim nga klasat tradicionale, një klasë virtuale është një klasë online që i lejon pjesëmarrësit të komunikojnë me njëri-tjetrin, t'i përcjellin prezantimet ose të ndjekin video, të ndërveprojnë me pjesëmarrësit tjerë dhe të angazhohen me resurset e grupeve të punës. Kjo do të thotë se në klasën virtuale nuk ekzistojnë muret që i rrethojnë pjesëmarrësit e procesit të mësimdhënies dhe nxënësve. Komunikimi në klasën virtuale ndërmjet mësuesit dhe nxënësve realizohet me anë të resurseve teknike dhe me ndihmën e internetit. Vetë fjala virtual do të thotë simulim ose krijim i një gjëje reale. Shi për këtë, klasat virtuale krijohen nëpërmjet internetit. Ato mundësojnë që nxënësit dhe mësuesi të jenë prezentë në procesin e mësimdhënies në kohë të njëjtë (reale), po në vende të ndryshme. Studimet e ndryshme për mësimdhënien tradicionale shprehin që mësimdhënia dhe të nxënësve është i suksesshëm me poqese karakteristikat si motivimi, menaxhimi, mjetet mësimore të mjaftueshme janë prezente në klasë. Në këtë studim kam hulumtuar a janë këto karakteristika prezente në klasat virtuale gjatë mësimdhënies online, gjegjësisht në klasat virtuale. Për ti pasur këto prezente mësimdhënësi duhet përveç njohurive nga lënda që e shtjellon ai duhet të ketë edhe shkathësi kompjuterike, vegla digjitale përkatëse dhe aplikacione kompjuterike përgjegjëse të lëndës përkatëse. Sa janë këto prezente në klasat virtuale gjatë mësimdhënies online gjatë pandemisë Covid 19 janë shtjelluar në këtë studim.

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE REZULTATET

Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 ishte shkaku që shumë shkolla ta ndërprejnë procesin e mësimdhënies. Kjo ndërprerje ndodhi në të gjitha nivelet e arsimit, që do të thotë edhe në universitete. Zgjidhja e vetme për ta tejkaluar këtë gjendje- ndërprerje e mësimdhënies ishte kalimi i mësimdhënies nga ajo me prezencë fizike në mësimdhënie nga distanca, por në kohë reale duke respektuar orarin e caktuar dhe platformën e përcaktuar për mësimdhënie. Fillimi ka qenë i vështirë për të gjithë, si për mësimdhënësit ashtu edhe për studentët. Vështërsitë

kanë qenë të llojllojshme: si faktori njeri poashtu edhe faktorët tjerë që mundësojnë/pengojnë realizimin e mësimdhënies. Duke i pasur parasysh këto gjëra dhe duke pasur tani mundësi për të krahasuar mësimdhënien me prezencë fizike me atë në largësi dhe në kohë reale është planifikuar që të realizohet ky hulumtim. Hulumtimi është realizuar gjatë semestrit veror të vitit akademik 2020/2021 që do të thotë ende pa u mbaruar pandemia e Covid -19. Ky hulumtim si instrument hulumtimi ka përdorur pyetësin, të cilin e kanë plotësuar vetëm 39 mësimdhënës të Universitetit të Tetovës, edhe pse i njëjti është dërguar një numri të konsiderueshëm mësimdhënësish. Pyetësi në fjalë është realizuar online dhe nga 39 mësimdhënësit, 24 janë të gjinisë femërore, të cilat e kanë plotësuar pyetësin. Mësimdhënësit e anketuar janë me përvojë pune të ndryshme, prandaj përvoja është ndarë në disa kategori. Gjatë përpunimit të pyetësorëve duke shfrytëzuar SPSS është konstatuar që nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve 48.7% (Tab.1) janë me përvojë pune me mbi 20 vite, 20.5% janë me përvojë pune prej 15 gjer 20 vite, po aq kanë përvojë pune prej 10 gjer 15 vite, ndërsa me më pak përvojë pune janë pjesa tjetër e mësimdhënësve pjesëmarrës në këtë studim.

Tab.1 Përvoja në mësimdhënie

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	0-5	1	2.6	2.6	2.6
	5-10	3	7.7	7.7	10.3
	10-15	8	20.5	20.5	30.8
	15-20	8	20.5	20.5	51.3
	>20	19	48.7	48.7	100.0
	Total	39	100.0	100.0	

Stafi akademik i Universitetit të Tetovës është i përbërë nga një numër i konsiderueshëm mësimdhënësish nga fusha të ndryshme studimi. Mësimdhënësit që kanë dhënë informatën kthyesë të pyetësorit janë mësimdhënës të shkencave shoqërore, shkencave matematiko-natyrore, shkencave teknike. Përfshirjen e mësimdhënësve sipas fushës ku realizojnë mësim e jep Tab.2.

Tab.2 Fusha e mësimdhënies

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	shkenca shoqërore	17	43.6	43.6	43.6
	Shk.matemat-natyrore	13	33.3	33.3	76.9
	shkenc teknike	4	10.3	10.3	87.2
	tjetër	5	12.8	12.8	100.0
	Total	39	100.0	100.0	

Mësimdhënia online është një përvojë e re tek mësimdhënësit. Kjo përvojë është përcjellur me vështësi si nga më të ndryshme; nga mungesat teknike, pengesat në lidhjet me internet, përvoja e pakët e mësimdhënësve dhe e studentëve. Kështuqë nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve 62% përqind prej tyre që kanë marrë pjesë në këtë studim me anë të plotësimi të pyetësorit janë deklaruar që nuk kanë përvojë në mësimdhënien online. Përvojë në mësimdhënien online 13% e mësimdhënësve e kanë fituar duke ndjekur kurse, që na shtynë të mendojmë se duke ndjekur të rejtat në mësimdhënie duhet aftësuar stafin mësimdhënës si në mënyrë kolektive ashtu edhe atë individuale me çka tejkalohen problemet e mundshme që mund të paraqiten në këtë Botë dinamike dhe të paparashikueshme. Por duke i pasur parasysh që në këtë lloj mësimdhënieje janë përdorur platforma të ndryshme, ku secila i ka pasur si avantazhet ashtu edhe disavantazhet problemet kanë qenë evidente. Këtë mundem ta them se në sukseshmërinë e mësimdhënies online ndikojnë shumë faktorë, një ndër faktorët është edhe natyra e lëndës. Lënda që kërkon që gjatë mësimdhënies përveç tjerash edhe të shkruash vazhdimisht (formula, vizatime,...) si p.sh matematikë, kimi, fizikë ka nevojë për një përkushtim më ndryshe sepse përpiluesit e platformave të ndryshme nuk mundin ti prashikojnë këto probleme. Mirëpo gjatë kësaj pandemie dhe përdorimit të gjërë të këtyre platformave jemi dëshmitarë që të njëjtat përsuan ndryshime në kuptimin pozitiv duke u dalë në ndihmë përdoruesve të tyre. Prandaj jo rastësisht mund të themi që çdo problem, pengesë është shtytë për avancim dhe zhvillim. Ku jemi këtu disa lëndë lejojnë që mësimdhënia të zhvillohet vetëm me prezencë verbale, por nga përpunimi i pyetësorit shihet që mësimdhënësit këtë lloj të mësimdhënies aspak nuk e përdorin ose shumë rrallë e përdorin dhe shprehur në përqindje 87.2% e mësimdhënësve janë deklaruar kështu. Që do të thotë se mësimdhënien për ta bërë më tërheqëse dhe për të nxitur kureshtjen e studentëve mësimdhënësit kanë pasur nevojë të përdorin dhe kanë përdorur mjete prezencive.

Sqarim, interpretim, përkujtim ose edhe demonstrim me Power Point që e kanë përdorur mësimdhënësit e paraqet Tab.3. Tek kjo tabelë numrat paraqesin një laramani. Nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve 41% prej tyre Power Pointin e kanë përdorur gjithmonë, shpeshë here 15% prej tyre dhe 31% e kanë përdorur rrallë.(Tab.3)

Tab.3 Përfaqësimi i përdorimit të Power Pointit në mësimdhënien Online

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	2	5.1	5.1	5.1
	shumë rrallë	3	7.7	7.7	12.8
	rrallë	12	30.8	30.8	43.6
	shpesh	6	15.4	15.4	59.0
	gjithmonë	16	41.0	41.0	100.0
	Total	39	100.0	100.0	

Vizualizimi, shkrimi dhe vizatimi në kohë reale gjatë mësimdhënies online është edhe një sfidë për mësimdhënësit e përkushtuar në profesion. Në këtë studim janë mbledhur të dhëna nga pyetësorët e përpunuar, të cilat tregojnë që 31% nga mësimdhënësit përdorin gjithmonë edhe mjete-vegla tjera gjatë mësimdhënies përveç atyre të cekura më lartë. Shpeshë herë përdorin mjete tjera 28% e mësimdhënësve nga numri i mësimdhënësve të përfshirë në këtë studim, ndërsa 36% e mësimdhënësve rrallë përdorin mjete tjera për të realizuar mësimdhënien.

Mësimdhënia kërkon përkushtim duke bërë pregaditje paraprake të kompletuar, e cila siguron sjelljen e vendimeve të qëlluara gjatë kohës së mësimdhënies posaçërisht nëse ajo realizohet në largësi dhe në kohë reale. Një nga pyetjet e përfshira në pyetësor ishte edhe sa mjetet e disponueshme kanë qenë të mjaftueshme për mësimdhënien që kanë realizuar. Plotësisht të mjaftueshme ka qenë përgjigjja e 48.7% e mësimdhënësve, ndërsa përgjigjja se këto mjete kanë plotësuar shumë nevojën për mësimdhënie ka qenë përgjigjja e 30.8% , ndërsa 15.4% e mësimdhënësve janë përgjigjur që mjetet e disponueshme pak i kanë plotësuar nevojat e mësimdhënies

Ora mësimore zhvillohet shumë më mirë dhe është shumë më e sukseshme poqese studentët janë të motivuar. Se si ti motivojmë ata mvaret nga aftësia e mësimdhënësit se sa është i përkushtuar që ta bëjë atë ose do të kisha thënë kjo mvaret edhe nga natyra e lëndës. Gjatë mësimdhënies online, në klasa virtuale sa kanë mundur ti motivojnë mësimdhënësit studentët e tyre janë shprehur pothuajse njëlloj për të gjitha mundësitë. Këtë mundemi ta vërejmë nga Tab.4. Ku 33.3% e mësimdhënësve janë shprehur se plotësisht kanë mundur ti motivojnë studentët gjatë ndjekjes së lëndës, 30.8% janë shprehur se kanë arritur shumë ti motivojnë ata dhe pak kanë arritur ti motivojnë studentët 30.8% e mësimdhënësve.

Tab.4. Motivimi i studentëve gjatë mësimdhënies online

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	shumë pak	2	5.1	5.1	5.1
	pak	12	30.8	30.8	35.9
	shumë	12	30.8	30.8	66.7
	plotësisht	13	33.3	33.3	100.0
	Total	39	100.0	100.0	

Menaxhimi i orës mësimore është poashtu një segment tjetër në kuadër të karakteristikave për të pasur orë të sukseshme. Duke pasur parasysh që studentët për shkak të lidhjeve të dobëta të internetit, mjeteve teknike jo të mjaftueshme ka ndoshtur që kamerat janë mbajtur të mbyllura, 51.3% e mësimdhënësve të anketuar janë shprehur se plotësisht kanë mundur të menaxhojnë orën mësimore në mënyrë të sukseshme, ndërsa të tjerët janë shprehur menaxhimi ka qenë shumë i mirë ose edhe më pak i mirë. Përvojë e pakët, ngarkesa nga pandemia janë faktorë të cilët gjithashtu kanë ndikuar edhe në bindjet e mësimdhënësve për procesin arsimor. Edhe mësimdhënësit edhe studentët kanë qenë gjithashtu edhe nën ndikimin e psikozës së pandemisë; sepse disa prej tyre kanë qenë pacient vetë ose dhe familjarët e tyre.

Mësimdhënia që ndjekin nxënësit, studentët duhet përshtatur aftësive individuale, sepse edhe mësimdhënia është e llojllojshme varësisht nga mësimdhënësi, lënda, vendi etj. Mësimdhënësit për ti tejkaluar disa vështërsi që hasin studentët gjatë të nxënësve mësimdhënien e përshtasin sipas aftësive, veçorive të nxënësve-studentëve. A kanë arritur mësimdhënësit ti njohin studentët e tyre nga largësia ka qenë pyetja e rradhës në pyetësorin e këtij studimi. Nga Tab.5 shihet që mësimdhënësit nuk kanë arritur ti njohin plotësisht studentët e tyre. Nga numri i përgjithshëm i

mësimdhënësve të anketuar 28.2 % prej tyre kanë njohur pak studentët e tyre dhe poaq kanë arritur shumë të njohin studentët.

Tab.5 Të dhëna për njohjen e aftësive individuale të studentëve gjatë mësimdhënies online

Valid	shumë pak	9	23.1	23.1	23.1
	pak	11	28.2	28.2	51.3
	shumë	11	28.2	28.2	79.5
	plotësisht	8	20.5	20.5	100.0
	Total	39	100.0	100.0	

Plotësisht kanë arritur të njohin studentët e tyre vetëm 20.5% e mësimdhënësve. Nga kjo themi që mësimi në largësi nuk mundëson njohjen e mjaftueshme të studentëve, e cila gjë pengon përshtatjen e mësimdhënies me aftësitë individuale të studentëve.

Teknologjia, largësia, mosnjohja e studentëve, si dhe elemente tjera ndikojnë që ndoshta studentët të shqetësuar në këtë kohë pandemie të keqpërdorin këtë lloj të mësimdhënies. Të dhënat e përpunuara paraqesin dyshimet e mësimdhënësve për keqpërdorime të mundshme nga ana e studentëve. Nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve 25.6% shprehen se ka pasur shumë pak keqpërdorime, 20.5% shprehen se ka pasur pak, ndërsa 33.3% e mësimdhënësve shprehen që ka pasur shumë keqpërdorime. Por, nëse mungesat dhe pengesat në këtë lloj mësimdhënieje tejkalohe me siguri që edhe keqpërdorimet do të minimizohen dhe zbatimi i këtij lloji të mësimdhënies do të jetë i sigurt.

Vlerësimi është pjesa më e dhimshme e procesit të mësimdhënies. Që të bëhet vlerësim i realt i studentëve duhet vlerësimi të jetë i shumëllojshëm, ndërsa kur është vlerësimi nga largësia atëherë duhet të jenë të disponueshme mjete (vegla) digjitale të llojllojshme dhe të sigurta. Mësimdhënësit vetëm 2% prej tyre shprehen që vlerësimi është plotësisht i realt, ndërsa 10% shprehen që është shumë i realt. Pjesa tjetër e mësimdhënësve mendojnë se vlerësimi është pak i realt, shumë pak i realt ose aspak i realt (28.2%, 35.9%, 17.9% respektivisht).

Mësimdhënia online nga njëra anë dhe të nxënëtit nga largësia janë dy elemente të cilat mvaren nga njëra tjetra. Mësimdhënësit me përvojë të pakët në mësimdhënien online, por me përvojë të mjaftueshme në mësimdhënien me presence fizike kanë dhënë mendimet e tyre në lidhje me sukseshmërinë e mësimdhënies online që e realizuan gjatë pandemisë Covid 19. Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara të kësaj pyetjeje flasin se 17.9% e mësimdhënësve shprehen se mësimdhënia nga largësia ka qenë aspak e sukseshme, ndërsa 38.2% e mësimdhënësve ndajnë mendimin që sukseshmëria e mësimdhënies online ka qenë shumë pak e sukseshme. Gjithashtu 30.8% e mësimdhënësve mendojnë se ky lloj i mësimdhënies ka qenë pak e suksesesshme. Këto të dhëna janë paraqitur me Tab.6

Tab.6 Opinioni i mësimdhënësve për sukseshmërinë e mësimdhënies online

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	7	17.9	17.9	17.9
	shumë pak	15	38.5	38.5	56.4
	pak	12	30.8	30.8	87.2
	shumë	4	10.3	10.3	97.4
	plotësisht	1	2.6	2.6	100.0
	Total	39	100.0	100.0	

Mësimdhënësit tani me përvojë në mësimdhënien online dhe atë me presence fizike shprehen (61.5% prej tyre) se preferojnë mësimdhënien me presencë fizike, ndërsa 35.9% prej numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve që kanë plotësuar pyetësorin preferojnë mësimdhënien e kombinuar ose që njihet edhe me emrin mësimdhënie hibride. Nga të dhënat e përpunuara në këtë studim është arritur të vërtetohet hipoteza:

H: Mendimi i mësimdhënësve në lidhje me mënyrën e mësimdhënies është në korelacion me sukseshmërinë e mësimdhënies, njohjen e studentëve, përshtjen e mësimdhënies sipas aftësive individuale të studentëve, menaxhimin e mësimdhënies dhe motivimin e studentëve. ($r=0.552$, $r=0.439$, $r=0.626$, $r=0.400$, $r=0.330$, ku $p=0.01$ dhe 0.05 respektivisht)

Tab.7 Tabela e korelacionit

		Preferoni	sukseshmëria	Vlersimi	Njohjaes tudente	keqpërdo rime	aftësiIndividual	menaxhimi	Motivimi	Mjetetmësimore
Preferoni	Pearson Correlation	1	.552**	.205	.439**	.107	.626**	.400*	.330*	.280
	Sig. (2-tailed)		.000	.211	.005	.515	.000	.012	.040	.084
	N	39	39	39	39	39	39	39	39	39

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed). * . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

3. PËRFUNDIMET DHE PROPOZIMET

Pas shqyrtimit të burimeve për mësimdhënien online dhe pas përfundimit të procesimit të të dhënave të mbledhura nga pyetësi i këtij hulumtimi mund të përfundojmë se gjatë kohës së pandemisë mësimdhënësit kanë mundur të realizojnë në mënyrë të suksesshme procesin e mësimdhënies, e cila ka ndikuar që studentët të mos ngecin me materialet mësimore të planifikuara për realizim. Gjatë kohës së pandemisë Covid 19, mësimdhënia i ka pasur karakteristikat e mësimdhënies; si menaxhim të mire, motivim të studentëve, shfrytëzim të mjaftueshëm të mjeteve mësimore digjitale për qartësim të përmbajtjes mësimore. Keqpërdorimet kanë qenë prezente gjatë mësimdhënies online diku më shumë e diku më pak. Por avancimi i vlerësimit online do të jetë zgjidhje për eliminim të këtyre keqpërdorimeve nga ana e studentëve. Shfrytëzimi i mësimdhënies online asinkronike dhe adaptimi me mësimdhënien online sinkronike bëri të mundur që problemi i mësimdhënies individuale dhe njohja e studentëve të tejkalohet. Pandemia Covid 19 ka ndikuar edhe në aspektin psikologjik si të studentëve poashtu edhe tek mësimdhënësit, por edhe pse stresi ka qenë prezent u arrit që mësimdhënia online të jetë praktikë e mirë për përdorim në Universitetin tonë. Mendimi i mësimdhënësve dhe atë 61.5% prej të anketuarve është se preferojnë mësimdhënien me prezencë fizike, kurse 35.9% preferojnë mësimdhënien e kombinuar ose emërtim që përdoret nëpër literaturë të ndryshme mësimdhënie hibride. Hipoteza e vërtetuar tregon që mendimi i mësimdhënësve në lidhje me cilin lloj të mësimdhënies ata preferojnë është në korelacion me sukseshmërinë e mësimdhënies, njohjen individuale të studentëve për të qenë më të sukseshëm, menaxhimin e orës mësimore, si dhe motivimin e studentëve gjatë mësimdhënies. Çdo lloj i mësimdhënies i ka anët pozitive si dhe ato negative. Çdo përvojë krijon qëndrime, mendime, opinione. Mësimdhënësit tani kanë përvojat në disa lloje mësimdhëniesh prandaj edhe i kanë mendimet e tyre, prandaj në këtë studim e kam parashtruar këtë pyetje si të fundit. Ndryshimet në arsim ndodhin dhe duhet të ndodhin në varshmëri nga ndryshimet në shoqëri, nevojat e shoqërisë, zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, prandaj institucionet arsimore duhet të ndjekin këto risi dhe të jenë në hap me kohën. Arsimi i shëndoshë është themeli i një kombi dhe i një shteti.

REFERENCAT

- Aguilera-Hermida, A. P. (2020). College students' use and acceptance of emergency online learning due to COVID-19, International Journal of Educational Research Open 1 100011.
- Awal, B., Wulan, A., Muhammad, M., & Aswar, R. (2021). Effectiveness of Online Learning In Pandemic Covid-19 International Journal Of Science, Technology & Management, ISSN: 2722-4015 Vol. 2 No. 4 (2021).
- Hendri, P., Mohamed, N.A., Azman, G., Kassymova, K., & Duisenbayeva, S. (2020). The Trend in Using Online Meeting Applications for Learning During the Period of Pandemic COVID-19: A Literature Review, Journal of Innovation in Educational and Cultural Research, Volume 1 Issue 2 Year Pages 58-68.
- Lokanath, M., Tushar, G., & Abha, Sh. (2020). Online teaching-learning in higher education during lockdown period of COVID-19 pandemic , International Journal of Educational Research Open 1 (2020)100012
- Muhammad, I., Betty, K., Yuyun, Y., Sri, A. W. (2020). CHALLENGES DURING THE PANDEMIC: USE OF E-LEARNING IN MATHEMATICS LEARNING IN HIGHER EDUCATION, Journal of Mathematics Education, Volume 9, No. 2,
- Musai, B. (2003). Metodologjia e mësimdhënies Tiranë
- Taylor, M. (2010). "Teaching Generation Next. A pedagogy for today's learners" A Collection of Papers Self – Study and Institutional Improvement 26th Edition (2010) The Higher Learning Commission